



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 80/2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN MBI VLERËN
E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 148 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 148

Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor

Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 10 për qind.”.

Neni 2

Pika 3 e nenit 149 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shuma që kompensohet është rezultat i shumëzimit të normës së kompensimit me vlerën totale të produkteve dhe të shërbimeve bujqësore, të furnizuara nga prodhuesi bujqësor, përgjatë një periudhe gjashtëmujore.”.

Neni 3

Neni 150 ndryshohet si më poshtë:

Mënyra e zbatimit të skemës

1. Blerësi i produkteve bujqësore, person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm të certifikuar, sipas legjislacionit në fuqi për turizmin, lëshon një faturë tatimore për shitësin, prodhues bujqësor për çdo furnizim mallrash dhe shërbimesh të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit, mbi të cilën aplikohet norma e kompensimit, sipas këtij ligji.

2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 101 të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit. Në faturë duhet të shënohet NIPT-i, sipas shkronjës “ç” të nenit 147 të këtij seksioni.

3. Kompensimi i akorduar i paguhet prodhuesit bujqësor nga administrata tatimore. Për të përfituar këtë kompensim, shitësi, prodhues bujqësor, duhet të dorëzojë në administratën tatimore, nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike, një kërkesë për kompensim, të shoqëruar me kopje të faturave të lëshuara nga blerësi i mallrave dhe shërbimeve bujqësore, si dhe numrin e llogarisë së tij bankare. Kërkesa për kompensim paraqitet sipas periudhave të mëposhtme:

a) brenda datës 31 dhjetor për furnizimet e kryera gjatë periudhës janar - qershor të vitit përkatës;
b) brenda datës 30 qershor të vitit pasardhës për furnizimet e kryera gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit paraardhës.

4. Administrata tatimore kryen kompensimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar në datën 11.12.2025